

VENDIM
Nr. 152, datë 28.4.2023

MBI PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGJINËS TË IMPIANTIT TË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE HEC “MOGLICË”, TË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SHA

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16 të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 14 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 229, datë 20.12.2019; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 901/6 prot., datë 26.4.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës të impianteve të prodhimit të energjisë elektrike HEC ‘Banjë’ dhe HEC ‘Moglicë’, të shoqërisë ‘Devoll Hydropower’ sh.a., për periudhën 1.1.2022–31.12.2022”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 901/1 prot., datë 28.3.2023 ka paraqitur kërkesën për pajisjen me certifikatën e garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, për vitin 2022.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 64, datë 11.4.2022, është vendosur pajisja me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, për vitin 2020 dhe 2021.

- Referuar nenit 14.2 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019, pas lëshimit të certifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për certifikatë garancie origjine do të depozitojë në ERE për qëllime të këtij aplikimi vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7, të kësaj rregulloreje.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 901/5 prot., datë 20.4.2023, shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. ka bërë me dije se nuk ka asnjë ndryshim të dokumentacionit respektiv për këtë central prodhues.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 901/4 prot., datë 19.4.2023, “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. ka informuar se sasia totale e energjisë elektrike e prodhuar për vitin 2022 nga HEC “Moglicë” është 322,491 mwh.

- Në zbatim të nenit 14.1 të rregullores, garancia e origjinës lëshohet për një periudhë 12-mujore dhe shteron fuqinë e saj, me përfundimin e këtij afati, të shprehur edhe në certifikatën e lëshuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pajisë me certifikatë të garancisë së origjinës impiantin e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. për një periudhë 12-mujore (1.1.2022–31.12.2022), për sasinë e prodhuar të energjisë elektrike 322,491 mwh.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti